



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
Komisioni i Konkurrencës**

---

**VENDIM**

**Nr.114, datë 26/05/2009**

**Për**

**“Disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në prokurimin publik të Shërbimit të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

Znj. Lindita	MILO (LATI)	Kryetar
Z. Lush	PERPALI	Zv/Kryetar
Znj. Servete	GRUDA	Anëtar
Znj. Rezana	KONOMI	Anëtar
Z. Koço	BROKA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26/ 05/2009, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Vlerësimi i ankesave të Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike

**Baza ligjore:**

- Neni 24, germa d) e f), dhe neni 70, pika 2, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Grupit të Punës “Për trajtimin e ankesave të Shoqërive të Ruajtjes dhe Sigurisë Fizike;
- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;

**VËREN SE:**

1. Procedura elektronike e prokurimit me objekt "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private te objekteve te Kryeministrit, Ministrive dhe institucioneve ne varësi te tyre", zhvilluar nga Autoriteti Kontraktor "Drejtoria e Përgjithshme e Prokurimeve të Përqendruara pranë Ministrit të Brendshme", rregullohet nga Ligji nr. 9643, dt. 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
2. Në ankesat e tyre SHRSF-të pretendojnë së në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesave për kualifikim, është shkelur legjislacioni mbi prokurimin publik.
3. Agjencia e Prokurimit Publik, ka për kompetencë shqyrtimin administrativ të ankesave me qëllim evidentimin e shkeljeve të ligjit të prokurimeve dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Këtë kompetencë të saj APP e ka ushtruar me marrjen e vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, objekt ankimi, me anë të shkresës nr. 4471/5 prot, datë 02.04.2009. Pas marrjes së këtij vendimi të APP-së, Autoriteti Kontraktor ka filluar një procedurë të re prokurimi me të njëjtin objekt.
4. Parë në këndvështrimin e ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës", në të dy procedurat e prokurimit u vu re ndarja e kontratës në lote në nivel qarku.
5. Ndarja e kontratës në lote në nivel qarku realizon bashkimin e kërkesës midis autoriteteve kontraktore që nuk kanë madhësi të krahasueshme dhe për rrjedhojë edhe oferta kërkohet në grup duke bashkuar operatorët ekonomikë ofertues të pa barabartë dhe jo të bashkë matshëm. Kjo metodë e aplikuar nuk u jep mundësi operatorëve ekonomikë që të paraqesin ofertë individuale, por i detyron ata që të marrin pjesë në tender vetëm me bashkim, duke sjellë kufizim të konkurrencës dhe duke penguar operatorët ekonomikë të hyjnë në këto procedura si ofertues individual. Kjo mënyrë e ndarjes në lote të kontratës përbën një barrierë hyrëse për në tregun e prokurimit të shërbimit dhe ruajtjes së sigurisë fizike në kuptim të ligjit "Për mbrojtjen e konkurrencës".

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d) e f), nenin 70, pika 2, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", me propozim të Sekretariatit,

#### **VENDOSI:**

1. T'i rekomandojë autoritetit kontraktor "Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqendruara" pranë Ministrisë së Brendshme, të rrisë numrin e loteve të kontratës publike me objekt "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private të objekteve të Kryeministrisë, Ministrive dhe institucioneve në varësi të tyre" me qëllim mundësimin e paraqitjes së kërkesave të grupuara sipas madhësive të krahasueshme të autoriteteve kontraktore me madhësinë e ofertave individuale nga operatorët ekonomikë. Në këtë mënyrë mundësohet rritja e konkurrencës midis operatorve që plotësojnë nivelet respektive të kërkesës.
2. T'i rekomandojë Agjencisë së Prokurimit Publik që në varësi të natyrës së kontratës që prokurohet, t'ju propozojë autoriteteve kontraktore ndarjen e kontratave në lote/nën-lote në mënyrë të tillë që të mundësohet një pjesëmarrje sa më e gjerë e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimeve publike duke siguruar një përdorim sa më të mirë të fondeve publike, nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë sipas madhësisë së ndërmarrjeve të vogla e të mesme në këto procedura, si dhe nxitjen e konkurrencës midis tyre.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për t'ia komunikuar këtë vendim palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Lush PERPALI**

**Servete GRUDA**

**Rezana KONOMI**

**Koço BROKA**

\_\_\_\_\_  
**Zv/Kryetar**

\_\_\_\_\_  
**Anëtare**

\_\_\_\_\_  
**Anëtare**

\_\_\_\_\_  
**Anëtar**

**Lindita MILO (LATI)**

\_\_\_\_\_  
**KRYETARE**